



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-AKP nr.02/2021

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarëve, Ragip Namani kryetar i kolegjit, Beshir Islami dhe Jelena Krivokapić, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, në çështjen juridike **të palës ankuese;**

Z. L. N. nga P.....,

sipas autorizimit e përfaqëson avokat, Nazmi Mustafi nga P.

Kundër:

Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, (tutje, AKKVP),

Duke vendosur lidhur me Ankesën e paraqitur, kundër Vërejtjes së fundit për dëbim dhe kthim të pronës në riposedim, të AKKVP, nr....., të datës 01 shkurt 2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë, 28 korrik 2021, merr:

A K T V E N D I M

Hudhet si e papranueshme Ankesa e Z. N., e paraqitur nga përfaqësuesi sipas autorizimit avokat Nazmi Mustafi, kundër Vërejtjes së fundit për dëbim dhe kthim të pronës në ri posedim të AKKVP, nr., të datës 01 shkurt 2021, e nxjerrë lidhur me zbatimin e Vendimit të plotfuqishëm të Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore,, të datës 16 dhjetor 2005, dhe vendimit përfundimtar, n...../03/2020, të datës, 07 maj 2020.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike;

Nga shkresat e lëndës të çështjes në shqyrtim në mënyrë kronologjike rezulton se; Komisioni për Kërkesa Pronësore Banesore, (tutje KKPb), me Vendimin nr. ..., të dt. 16 dhjetor 2005, ka vendosur, që kërkesa e kategorisë “A”,, e palës kërkuese, z. T. G., të aprovohet dhe atij ti kthehet e drejta e pronësore, në banesën e cila gjendet në rr...., në P., në sipërfaqe prej 48m², ndërsa palës përgjegjëse në kërkesën e kategorisë “A”, për të njëjtën pronë, përkatësisht parashtruesit të kërkesës së kateg. “C”,, z. S. S., me të njëjtin vendim vendoset që ti njihet e drejta në kompensim, si në kuptim të nenit 4, të Rreg. së UNMIK 2000/60, e që bazuar në këtë vendim duhet të plotësohen kushtet e përcaktuara sipas arsyeve të dhëna në pikën (1), (2) dhe (3), si dhe paragrafëve 5, 6, 7, 11, 14, 16, 18, 19, 21 dhe 22, të cilët aplikohen veqanërisht për kërkesat në fjalë të cekura si më lartë. Me këtë Vendim ishin njoftuar palët dhe në afatin e paraparë ligjor anjëra palë nuk kishte ushtruar kërkesë për rishqyrtim të këtij Vendimi në Komisionin e shkallën e dytë.

1. Sipas Ligjit 05/L-010, AKKVP, për veq mandatit kryesor të saj, ka trashëguar një pjesë të përgjegjësisive dhe të mandatit të Agjencisë Kosovare të Pronës dhe të ish Drejtorisë për Kërkesa Pronësore dhe Banesore, **(kësaj të fundit kryesisht lidhur me implementimin e vendimeve të sajë të plotëfuqishëm), ashtu si parashihet në nenet 17-19 dhe 22 të këtij ligji.**
2. AKKVP, bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit nr. 05/L-010, të cekura si më lartë, në këtë çështje në kuptim të nenit 6 të U.A. nr.10/2018, e kishte njoftuar parashtruesin e kërkesës së kategorisë “A”, z. G. se ka filluar implementimin e Vendimit nr., të dt. 16 dhjetor 2005 për kthimin. Më pas AKKVP kishte pranuar kërkesën e e znj. D. G.bashkëshorte e z. T. G. e cila kishte kërkuar kthimin e të drejtës pronësore, sipas Vendimit të KKPb. Agjencia përkatësisht komisioni vlerësues, duke vepruar sipas rregullave dhe procedurave, ashtu si parashihet në nenin 22 par. 5 të Ligjit nr. 05/L-010, në zbatim të Rreg. së UNMIK 2000/60, dhe procedurave të skemës së kompensimit të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ, nr. 10/2018, përkatësisht sipas neneve 10, par.1 dhe 2, nenit 4.4 dhe nenit 6.5 të këtij udhëzimi, në zbatim të vendimit të plotëfuqishëm të lartë cekur të Komisionit për Kërkesa Banesore Pronësore,, të dt. 16 dhjetor 2005, pas përcaktimit të shumës së privatizimit për banesën lëndore, pagesës së kryer të shumës së privatizimit dhe

përfundimit të procedurave, lënda i dërgohet Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës për marrjen e vendimit përfundimtar.

3. Me vendimin përfundimtar të Komisionit, nr.....03/2020, të dt. 07 maj 2020, dhe vendimin individual të vërtetuar, të dt. 01.07.2020, sipas kërkesës së tij nr., në zbatim të vendimit të plotëfuqishëm, me nr...., të dt. 16 dhjetor 2005, z.T.G. i kofirmohet pronësia mbi pronën lëndore-banesën e cila gjendet në, në P., në sipërfaqe prej 48m², dhe urdhërohet që i njëjti të regjistrohet si pronar ligjor i banesës lëndore në shënimet publike përkatëse, nga dita e pranimit të vendimit-urdhërit. Ndërsa çdo person, apo palë përgjegjëse, që pa të drejtë e ka uzurpuar apo gjendet në banesë duhet ta liroj në afat prej 30 ditë, dhe nëse personi pa të drejtë banimi nuk i bindet urdhërit për lirim e pronës, brenda afatit të dhënë, do të dëbohet nga prona.
4. Me Njoftimin për lirim e pronës lëndore të dt. 19.10.2020, si dhe Vërejtjen e fundit për dëbim dhe kthim të pronës në riposedim,, të dt. 01.02.2021, pala-banuesi në këtë pronë është njoftuar se deri me datë 04.02.2021, duhet ta liroj pronën lëndore dhe t,ia mundësoi shfrytëzimin e lirë bartësit të drejtës pronësore.
5. Pala ankuese Z. N., për mes përfaqësuesit sipas autorizimit avokat Nazmi Mustafi kundër kësaj Vërejtje, të dt. 01.02.2021 të AKKVP, i nxjerrë në zbatim të vendimit të plotëfuqishëm të KKPb-së dhe Vendimit përfundimtar KKPK-së, ushtron ankesë në Gjykatë Supreme me të cilën e konteston ligjshërinë e të njëjtes për shkak të; Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së LPK-së, zbatimit të gabuar të drejtës materiale dhe Cenimit të dispozitave nga neni 31, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Në arsyetim të ankesës ndër të tjera thekson se AKKVP, ish “HABITATI”, pabazë ligjore me dt. 01.02.2021, ka lëshuar vërejtjen-urdhërin ndaj palës ankuese për dëbim, sepse ky është pronar i vetëm legjitim sepse kjo çështje është përfunduar me Vendimin gjyqësor C.nr.586/11, i formës së prerë të Gjykatës Komonale në Prizren, tutje thekson se palës ankuese janë duke iu cenuar të gjitha të drejtat legjitime, sepse pronën e njëjtë e ka të regjistruar në emër të tij në kadastrë, sipas Certifikatës së të Drejtave Pronësore, ZK P., të cilën banesë në mënyrë ligjore e ka blerë nga ish pronari S. S.

sipas kontratës së noterizuar OPR/213, se ish pronari e kishte fituar të drejtën në këtë banesë prej vitit 1992, gjer sa D. G. ose ndonjë person i tretë asnjëherë nuk ka qenë pronar faktik apo juridik i kësaj prone. Tutje në ankesë thekson se është bërë aplikim i gabuar i të drejtës materiale duke u zbatuar Rreg. 1999/23 neni 2.5 neni 2.7 sepse kjo është në kundërshtim me Ligjin për AKKVP, se me mënyrën e vendosjes i janë cënuar të drejtat kushtetuese nga neni 31, 54, të Kushtetutës së R.Kosovës si dhe nga neni 35 I KEDNJ, etj. Në fund propozon që ankesa të aprovohet në tërësi si e bazuar, të anulohet Vërejtja-Vendimi i AKKVP, i dt. 01.02.2021, të vërtetohet që i dëmtuari është pronar i banesës lëndore e cila në kadastër është e regjistruar në emër të tij , të detyrohet AKKVP, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës të bëjë kthimin e çelsave të dëmtuarit z.Zejnel Ninaj, dhe në pagesën e shpenzimeve të procedurës dhe përfaqësimit sipas TA.

Arsyetimi ligjor;

-Juridiksioni,

6. Gjykata Supreme, kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e lëndëve sipas ankesës të ish Agjencisë Kosovare të Pronave, tani Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të tjera të paraqitura nga pala ankuese gjen se, kjo gjykatë nuk ka kompetencë ligjore për të vendosur, lidhur me Vendimet e ish Komisionit për Kërkesa Pronësore Banësore,(KKPB), si dhe aktit përfundimtar të cilin e konteston me ankesë, përkatësisht Vërejtjes së fundit të AKKVP të dt. 01.02.2021, të nxjerrë në përfundim të procedurës së ekzekutimit të vendimeve të plotëfuqishme konkrete të KKPB, sipas të cilëve kjo çështje banësore lidhur me kërkesën lëndore, është vendosur me vendimin përfundimtar si u cek më lartë,....., të datës 16 dhjetor 2005, dhe Vendimin përfundimtar për ekzekutim dhe regjistrim të pronës në shënimet përkatëse publike, të datës 07 Maj 2020.
7. Sipas Ligjit në fuqi nr.05/-L-010, për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, nuk është e paraparë që vendimet e Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banësore, përkatësisht Komisionit për Kërkesa Pronësore Banësore në kuadër të kësaj Drejtorie, apo aktet e tjera të lidhura me këto vendime dhe zbatimin e tyre, si në rastin

konkret, Vërejtjes së fundit,, të dt. 01.02.2021, se mund të jenë objekt i kontestimit qoft me padi apo me ankesë në Gjykatë Supreme, gjer sa sipas neneve 17-19 dhe 22 të këtij ligji, AKKVP ka kompetencë të ekzekutoj vendimet e plotëfuqishme të Komisionit për Kërkesa Pronësore, aktgjykimet e Gjykatës Supreme dhe **Vendimet e Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore, dhe të bëjë lëshimin dhe ekzekutimin e urdhërit për dëbim të qdo personi që është duke qëndruar në mënyrë të pa ligjshme në një pronë, të vendosur me vendim të plotëfuqishëm të Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore (KKPB).**

8. Sipas nenit 2.7, të Rregullores së UNMIK, nr.1999/23, të datës 15 Nëntor 1999, Vendimet e Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore, janë të detyrueshme për tu zbatuar **dhe nuk janë objekt i ri i shqyrtimit nga asnjë organ tjetër gjyqësor apo administrativ në Kosovë.**
9. Vendimi bazë,, i dt. 16 dhjetor 2005, është i plotëfuqishëm, në pajtim me nenin 2, paragraf 7, të Rregullores së lartë cekur, nr. 1999/23, andaj i njëjti nuk mund të ankimohet, në këtë fazë, as sipas Rregullores së UNMIK nr.2000/60, sepse dispozitat e këtyre dy Rregulloreve të cekura si më lartë, si dhe aktet ligjore të më vonshme, dhe tani në fuqi që e rregullojnë këtë lëmi, nuk parashofin ndonjë mjet juridik të rregulltë, apo të jashtëzakonshëm të goditjes ndaj vendimeve përfundimtare të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore.
10. Sipas dispozitave të Rregullores së lartë cekur, nr. 1999/23, pas vendosjes nga Komisioni për Kërkesa Pronësore Banesore me vendim, i cili është bërë i formës së prerë, çështja e vendosur trajtohet, *res judicata*, **sepse sipas nenit 2.5, të kësaj Rregullore, në çështjet e pronave banesore, jurisdiksioni i gjykatave lokale ishte përjashtues, ndërsa komisioni ka kompetenca ekskluzive për të zgjidhë kategoritë e kërkesave të theksuara si në nenin 1.2, të kësaj Rregullore.**
11. Ngjajshëm është edhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës sa u përket vendimeve të formës së prerë të Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore,

(shih Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, në rastin **me numër, KI 104/10**, e në mënyrë specifike paragrafët, 64-75, të këtij aktgjykimi).

12. Nga të lartë cekurat e në kuptim të nenit 13, par. 1 dhe 2, dhe neni 13.3 c), të Rregullores së UNMIK, nr. 2006/50, e ndryshuar me Ligjin, nr. 03/L-079, dhe neni 16.3, parag.3.2, të Ligjit 05/L-010, për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Këshilla Juridike;

13. Sipas nenit 13.6, të Ligjit 03/L-079, ky aktvendim është i plotfuqishëm, i njëjti nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË
AC-AKP nr. 02/2021, me datë 28 korrik 2021

Bashkp. Profesional,
Sherif Krasniqi

Kryetari i Kolegjit,
Ragip Namani